GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 49516/17
Mariglen AVDIU dhe të tjerë
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur më 23 maj 2023, si Komision, i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar,*
Darian Pavli,
Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*
dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh,

kërkesën (nr. 49516/17) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), më 12 korrik 2017, nga kërkuesit e listuar në tabelën bashkëlidhur ("kërkuesit"), të cilët u përfaqësuan në Gjykatë nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve ("QEDR"), një organizatë joqeveritare me seli në Bruksel, Belgjikë dhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, një organizatë joqeveritare me seli në Tiranë;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për diskriminim ndaj kërkuesve si rezultat i moszbatimit nga Qeveria i masave për mos segregim në një shkollë fillore, që frekuentohej ekskluzivisht nga fëmijët e minoritetit rom.

2. Kërkuesit janë 15 familje me origjinë rome që jetojnë në Moravë, Berat, një fshat në Shqipëri, zonë në të cilën komuniteti rom përbën një të tretën e popullsisë.

3. Në kohën kur u depozitua kërkesa, fëmijët po ndiqnin ose priteshin të ndiqnin shkollën "Avdyl Avdya", një shkollë fillore e ndërtuar në vitin 2002. Shkolla ofronte arsimin e detyruar fillor në klasa të grupuara. Numri i fëmijëve në shkollë varionte nga 23 në 29, dhe të gjithë ishin nxënës romë. Ato pak familje që nuk ishin rome i çonin fëmijët në shkolla të tjera.

4. Nxënësit nga shkolla "Avdyl Avdya" mund t'i përfundonin studimet e tyre të detyrueshme në shkollën "Shaban Sollaku" dhe të dyja shkollat ishin në të njëjtën njësi administrative. Në vitet e mëparshme, përpara kërkesës, vetëm pesë deri në gjashtë nxënës nga shkolla "Avdyl Avdya" i kishin vazhduar studimet në shkollën "Shaban Sollaku". Sipas kërkuesve, kjo gjë ndodhte si pasojë e cilësisë së dobët të arsimit që nxënësit merrnin në shkollën "Avdyl Avdya".

5. Pas një ankese të depozituar më 17 qershor 2015 nga QEDR-ja, më 16 korrik 2015, Drejtoria Rajonale e Arsimit Berat (Drejtoria e Arsimit) pranonte

ekzistencën e segregimit ndaj fëmijëve romë në shkollën "Avdyl Avdya", dhe nevojën për t'i dhënë fund kësaj situate. Megjithatë, Drejtoria e Arsimit parashtroi se transporti falas për fëmijët për të shkuar në shkollën "Shaban Sollaku" nuk ishte i mundur, sepse nuk përmbushej distanca minimale për ofrimin e transportit falas për nxënësit në një shkollë.

6. Pas një ankese tjetër të depozituar më 3 shtator 2015 nga QEDR-ja, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipëri ("Komisioneri"), më 16 dhjetor 2015, mori një vendim sipas së cilit vlerësohej se kërkuesit ishin diskriminuar në fushën e arsimit nga Ministria dhe Drejtoria e Arsimit, për shkak të racës së tyre. Komisioneri urdhëroi zbatimin e hapave të nevojshëm duke përfshirë mbylljen e shkollës dhe transportin falas për fëmijët romë në një shkollë të integruar.

7. Më 10 prill 2018, kërkuesit informuan Gjykatën se nxënësit kërkues kishin filluar të ndiqnin shkollën "Shaban Sollaku". Më 27 mars 2023, kërkuesit informuan Gjykatën se Ministria kishte miratuar mbylljen e shkollës "Avdyl Avdya". Nxënësit kërkues kishin vijuar të ndiqnin shkollën e integruar, arsimimi i tyre kishte vijuar rregullisht, dhe ata ishin mirëpritur në shkollën e re. Autoritetet publike kishin organizuar transportin dhe prindërit ishin rimbursuar për shpenzimet e transportit, fillimisht me anë të palëve të treta dhe më pas nga Bashkia e Beratit. Kërkuesit nuk paraqitën ndonjë padi pranë gjykatave vendase ku të pretendonin se nuk kishte mjete efektive në çështjen e tyre.

LIGJI PËRKATËS VENDAS

8. Parashikimi përkatës i ligjit kundër diskriminimit, ligji nr. 10221, i datës 5 shkurt 2010, parashikon si më poshtë:

Neni 1

"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë për sa i përket racës, etnisë (...)".

Neni 34

"1. Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për 17 dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale. 2. Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale."

VLERËSIMI I GJYKATËS

9. Kërkuesit u ankuan mbështetur në nenin 1 të protokollit nr. 12 të Konventës, se ata ishin diskriminuar kundër të drejtës së tyre për një arsim përfshirës si rezultat i moszbatimit nga ana e autoriteteve i masave që shmangnin segregimin, për të adresuar mbipërfaqësimin e nxënësve romë në shkollën "Avdyl Avdya".

10. Gjykata thekson se një vendim apo masë e favorshme për një kërkues në parim nuk është mjaftueshëm për të privuar kërkuesin nga statusi i tij i "viktimës" nëse autoritetet kombëtare nuk pranojnë shprehimisht ose në substancë, dhe më pas ofrojnë një zgjidhje për shkeljen e Konventës (shih *Murray kundër Holandës* [DHM], nr. 10511/10, § 83, 26 prill 2016, dhe *Nada kundër Zvicrës* [DHM], nr. 10593/08, § 128, GJEDNJ 2012). Pranimi apo zgjidhja zakonisht përftohen me anë të shterimit të mjeteve vendase (shih *Staykov kundër Bullgarisë,* nr. 49438/99, § 89, 12 tetor 2006 dhe *C dhe D kundër Kroacisë* (vendim), nr. 43317/07, 14 tetor 2010).

11. Në çështjen *X dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 73548/17 dhe 45521/19, § 63, 31 maj 2022), Gjykata thekson se mjetet vendase duhet të jenë "efektive" në kuptimin që ose të ndalojnë shkeljen e pretenduar ose ta ndërpresin atë, ose të ofrojnë zgjidhjen e duhur për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur (shih *A.H. dhe të tjerët kundër Rusisë,* nr. 6033/13 dhe 15 të tjerë, § 347, 17 janar 2017). Në atë rast, thelbi i ankesave të kërkuesve kishte të bënte me faktin se autoritetet nuk po ndërprisnin një situatë që vazhdonte, më konkretisht segregimin e nxënësve romë/egjiptianë në një shkollë. Mbështetur në rrethanat, Gjykata vendosi se mjeti që ofronte perspektivën vetëm për kompensim financiar, pa ndaluar vijimësinë e shkeljes financiare, nuk mund të konsiderohej efektiv (shih *mutatis mutandis, Patranin kundër Rusisë*, nr. 12983/14, § 86, 23 korrik 2015).

12. Megjithatë, situata e kërkuesve në çështjen konkrete ndryshon, jo vetëm sepse autoritetet e pranuan se kërkuesit ishin diskriminuar, por edhe sepse ata e kompensuan situatën. Në lidhje me këtë gjë, Gjykata thekson se në vendimin e sipërpërmendur të datës 15 dhjetor 2015, Komisioneri pretendonte se Ministria dhe Seksioni i Arsimit kishin diskriminuar nxënësit romë në fushën e arsimit, duke përfshirë kërkuesit, për shkak të racës së tyre, pasi në shkollën "Avdyl Avdya" kishte pasur segregim. Në mbështetje të këtyre konstatimeve, Gjykata gjykon se autoritetet vendase kanë pranuar shprehimisht një shkelje të së drejtës të kërkuesve për t'u mos diskriminuar.

13. Në vijim, kërkuesit informuan Gjykatën se autoritetet vendase kishin ndërmarrë një sërë hapash për të adresuar ankesat e tyre. Shkolla "Avdyl Avdya" ishte mbyllur zyrtarisht në vitin 2018. Nisur nga semestri i dytë i vitit shkollor 2017/2018, Bashkia e Beratit kishte ofruar transport për fëmijët në shkollën e re dhe rimbursim për kostot e transportit për familjet përkatëse. Kërkuesit pohuan se cilësia e arsimit në shkollën e re ishte e përshtatshme.

14. Sipas Gjykatës, autoritetet përkatëse kanë respektuar detyrimin e tyre pozitiv për të ndërmarrë hapa për të korrigjuar pabarazinë e pretenduar ndaj kërkuesve dhe kanë shmangur segregimin e tyre në shkollën "Avdyl Avdya".

15. Çështja tjetër që duhet të vlerësohet është nëse kërkuesit morën kompensimin e duhur për shkeljen e të drejtës së tyre për t'u mosdiskriminuar. Në lidhje me këtë asket, Gjykata përsërit se detyrimi për të shteruar mjetet vendase kërkon që kërkuesit të përdorin normalisht mjetet e disponueshme dhe të mjaftueshme, në lidhje me pretendimet e tyre për shkeljet të Konventës. Për të qenë efektiv, një mjet duhet të mund të kompensojë drejtpërsëdrejti aspektin e kundërshtuar të situatës dhe duhet të ofrojë perspektivën e

arsyeshme për sukses (shih, për shembull, *Gherghina kundër Rumanisë,* [DHM] (vendim), nr. 42219/07, § 84, 9 korrik 2015).

16. Vendimi përfundimtar i Komisionerit ku pranohet shprehimisht diskriminimi i nxënësve kërkues, i dha kërkuesve një mundësi të arsyeshme për të përftuar kompensim sipas nenit 34 të ligjit kundër diskriminimit (ligji nr. 10221 i datës 4 shkurt 2010), i cili parashikon se kushdo që është diskriminuar ka të drejtën të kërkojë kompensim për dëmet përpara një gjykate kompetente, pavarësisht nëse ai ose ajo ka depozituar një ankesë pranë Komisionerit. Megjithatë, kërkuesit nuk kanë kërkuar kompensim me anë të një padie civile ndaj Shtetit. E teksa nisja e një procesi civil për shpërblim në vetvete nuk mund të shpërblejë plotësisht një shkelje të përsëritur për t'u mos diskriminuar, ky proces së bashku me pranimin nga ana e Komisionerit për një shkelje të së drejtës të tyre për t'u mosdiskriminuar, dhe masat pozitive për të adresuar diskriminimin, përmbushin kërkesat e efektivitetit. Gjithashtu, kur Komisioneri gjykon se është shkelur e drejta e kërkuesve për t'u mos diskriminuar, kërkuesit duhet të ndjekin mjetet të përftuar kompensim për atë shkelje në të shkuarën. Kërkuesit nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

17. Sipas rrethanave, për sa ka të bëjë me ankesën e kërkuesve në lidhje me periudhën përpara muajit prill 2018, ajo duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshterim të mjeteve vendase.

18. Në lidhje me pretendimin e kërkuesve për periudhën pas muajit prill 2018, Gjykata tashmë ka vlerësuar se autoritetet kanë marrë masat e duhura për ta ndërprerë situatën për të cilën ankohen kërkuesit (shih paragrafin 16 më sipër). Kërkuesit nuk kanë paraqitur ndonjë argument apo informacione që do të tregonin të kundërtën. Rezulton se duke ndaluar segregimin në shkollimin e nxënësve kërkues dhe duke iu siguruar mjetet e duhura të transportit në një shkollë ku nuk ka segregim, ku niveli i arsimimit është i përshtatshëm, autoritetet vendase kanë kompensuar situatën e kërkuesve dhe për këtë arsye, kërkuesit nuk mund të pretendojnë më të jenë viktima të shkeljes së pretenduar.

19. Sipas rrethanave, për sa ka të bëjë me ankesën e kërkuesve në lidhje me periudhën që prej muajit prill 2018, ajo nuk përputhet *ratione personae* me parashikimet e Konventës sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) dhe për këtë arsye duhet të kundërshtohet sipas nenit 35 § 4.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

E deklaron kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar më shkrim më 15 qershor 2023.

Olga Chernishova	**Georgios A. Serghides**
ZËVENDËSREGJISTRARE	KRYETAR

SHTOJCË
LISTA E KËRKUESVE

Nr.	Emri i kërkuesit	Viti i lindjes/regjistrimit	Kombësia	Vendbanimi
1	Mariglen AVDIU	1998	shqiptar	Berat

2	Elio AVDIU	2013	shqiptar	Berat
3	Endri AVDIU	2004	shqiptar	Berat
4	Ermal AVDIU	1984	shqiptar	Berat
5	Eva AVDIU	2009	shqiptar	Berat
6	Flori AVDIU	2004	shqiptar	Berat
7	Iljaz AVDIU	1973	shqiptar	Berat
8	Leonard AVDIU	1987	shqiptar	Berat
9	Nadia AVDIU	2012	shqiptar	Berat
10	Paloma AVDIU	2009	shqiptar	Berat
11	Senada AVDIU	2007	shqiptar	Berat
12	Juliana MILE	2008	shqiptar	Berat
13	Klodjan MILE	1976	shqiptar	Berat
14	Nuri MILE	1975	shqiptar	Berat
15	Xhensia MILE	2004	shqiptar	Berat
16	Adelaide MYRTELI	2009	shqiptar	Berat
17	Adelajda MYRTELI	2009	shqiptar	Berat
18	Aleksandros MYRTELI	2008	shqiptar	Berat
19	Alex MYRTELI	2003	shqiptar	Berat
20	Alexandro MYRTELI	2008	shqiptar	Berat
21	Angelo MYRTELI	2008	shqiptar	Berat
22	Antonela MYRTELI	2014	shqiptar	Berat
23	Arjola MYRTELI	2003	shqiptar	Berat
24	Elton MYRTELI	1986	shqiptar	Berat
25	Ermal MYRTELI	1988	shqiptar	Berat
26	Gabriel MYRTELI	2011	shqiptar	Berat
27	Iljada MYRTELI	2005	shqiptar	Berat
28	Jolanda MYRTELI	1988	shqiptar	Berat
29	Kristo MYRTELI	2007	shqiptar	Berat
30	Laura MYRTELI	2008	shqiptar	Berat
31	Laureat MYRTELI	1982	shqiptar	Berat
32	Liverin MYRTELI	2016	shqiptar	Berat
33	Sentiljan MYRTELI	1986	shqiptar	Berat
34	Valter MYRTELI	1983	shqiptar	Berat
35	Vullnet MYRTELI	1968	shqiptar	Berat
36	Dallandyshe TIFI	1982	shqiptar	Berat
37	Danjel TIFI	2005	shqiptar	Berat
38	Manuel TIFI	2005	shqiptar	Berat
39	Elona YZEIRI	1984	shqiptar	Berat
40	Klaus YZEIRI	2004	shqiptar	Berat
41	Martino YZEIRI	2009	shqiptar	Berat
42	Vionis YZEIRI	2006	shqiptar	Berat